

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN

AKTIVITETI:

ID 1.10, Veprimtaria: Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane.

ID 1.7, Veprimtaria: Gaz natyror aromatik ose GNL, përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A, ose përzierje e aromave.

Vendndodhja: Lezhe Lezhe LEZHE Lagjja Beslidhja, Pike Karburanti, ngjitur me anen jugore të rruges "SHTRAUS", afro 150 m nga kryqezimi i lagjes GURRA të qytetit të Lezhës

Kërkues: Subjekti Juridik "A.F.M.A" sh.p.k. / NIPT K68119501H

Administratori: z. Fatmir Gjoni



Maj, 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE

1.TË PËRGJITHSHME.....	3
2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT.....	9
2.1. Qëllimi i projektit	
2.2. Vendndodhja e aktivitetit	
2.3 Lidhja e objektit me infrastrukturën inxhinierike	
2.4. Përshkrimi i proceseve teknologjike të aktivitetit	
3. INFORMACION PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS.....	13
3.1. Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis	
3.2. Masat e nevojshme për zbutjen e ndikimeve	
4.PROGRAMI I MONITORIMIT.....	14
4.1.Qëllimet e monitorimit mjedisor	
4.2. Objektivat e Monitorimit	
5. PËRPARESITE E PROJEKTIT/PËRFUNDIME.....	15

1. TË PËRGJITHSHME

Shoqëria "A.F.M.A" sh.p.k. me administrator z.Fatmir Gjoni, është një subjekt juridik i regjistruar në QKB me NUIS **K68119501H**. Sipas ekstraktit të QKB-së, subjekti "A.F.M.A" është shoqëri aksionare, themeluar me 13.09.2002.

Zyra qendrore/zyra e përfaqësimit në Shqipëri është në adresën: LEZHE Lagjja Beslidhja, Pike Karburanti,ngjitur me anen jugore te rruges "SHTRAUS", afro 150 m nga kryqezimi i lagjes GURRA te qytetit te Lezhes.

Subjekti "A.F.M.A", si objekt të veprimtarisë së tij ka:

Ne fushen e tregtimit me pakice te karburanteve, vajrave, lubrifikanteve dhe aksesoreve te tyre . Ne fushen e tregtimit dhe te import eksportit te mallrave industriale dhe ushqimore, veshmbathje, konfeksione, hidrosanitare, hidraulike, elektrike, detergjente, artikuj tualeti dhe kozmetike, kanceleri per zyra e shkolla,orendi shtepiake,mobilje,paisje elektrike,paisje elektronike e elektroshtepiake,paisje dhe dhe aksesore telefonie,fruta perime,produkte bujqesore dhe blektorale,bime medicinale e eterovajore,pije te ndryshme alkalike e freskuese,automjete te te gjitha llojeve.etj. Transport per vete dhe per te tjeret te mallrave te te gjitha llojeve. Prodhim dhe tregtim materiale ndertimi,te materialeve duralumin,plastike dhe druri,dyer e dritare shkollore etj,pjese kembimi per makina e automjete,goma e bateri,pike servisi lavazh. Ne fushen e sherbimeve Bar -Restorant. Pike servisi lavazh. Si dhe cdo aktivitet te lejuar me ligj. Tregetim te gazit te lengshem per automjete.

Subjekti 'A.F.M.A' sh.a. eshte pajisur me pare me Autorizim Mjedisor me nr. PN-5046-03-2013 me kod te leshuar me date 7.3.2013, per veprimtarine "Per piken e tregtimit me pakice te karburantit" me adrese ne Lezhe, rruga Shtraus.

Shoqëria 'A.F.M.A' sh.a., përfaqësuar nga administratori z.Fatmir Gjoni, kane ne pronesi pronen ku ndodhen objektet ku ushtrohet aktiviteti, sipas certifikates nr.1178910 per pronen me nr. 5/131, me sipërfaqe 845 m², nga te cilat 228.5 m² jane ndertese, ne zonen kadastrale 8632, volumi 30, faqe 220.

Dukë parë të gjithë fushën e veprimtarisë ku operon, subjekti kërkon te vazhdoje zhvillimin e aktivitetin te furnizimit me karburant sipas percaktimeve te mesiperme.

Aktiviteti eshte ne funksion prej shume vitesh dhe subjekti eshte pajisur me pare me leje mjedisi per aktivitetin perkates sipas percaktimeve ligjore te kohes, por qe eshte shfuqizuar sipas ndryshimeve ligjore te ligjit nr.52/2020.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	K68119501H
2. Data e Regjistrimit	22/06/2006
3. Emri i Subjektit	"A.F.M.A."
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	22/06/2006
6. Kohëzgjatja	Nga: 22/06/2006
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Lezhe Lezhe LEZHE Lagjja Beslidhja, Pike Karburanti,ngjitur me anen jugore te rruges "SHTRAUS",afro 150 m nga kryqezimi i lagjes GURRA te qytetit te Lezhes
8. Kapitali	19.360.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	10.000,00
9. Objekti i aktivitetit	Ne fushen e tregimit me pakice te karburanteve, vajrave, lubrifikanteve dhe aksesoreve te tyre . Ne fushen e tregimit dhe te import eksportit te mallrave industriale dhe ushqimore, veshmbathje, konfeksione, hidrosanitare, hidraulike, elektrike, detergjente, artikuj tualeti dhe kozmetike, kanceleri per zyra e shkolla,orendi shtepiake,mobilje,paisje elektrike,paisje elektronike e elektroshtepiake,paisje dhe aksesore telefonie,fruta perime,produkte bujqesore dhe blektorale,bime medicinale e etero-vajore,pije te ndryshme alkalike e freskuese,automjete te te gjitha llojeve.etj. Transport per vete dhe per te tjeret te mallrave te te gjitha llojeve. Prodhim dhe tregtim materiale ndertimi,te materialeve duralumin,plastike dhe druri,dyer e dritare shkollore etj,pjese kembimi per makina e automjete,goma e bateri,pike servisi lavazh. Ne fushen e sherbimeve Bar -Restorant .Pike servisi lavazh.Si dhe cdo aktivitet te lejuar me ligj.Tregetim te gazit te lengshem per

Fig. 1 Pjese nga ekstrakti i subjektit

2. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

2.1. Qëllimi i aktivitetit

Qëllimi i aktivitetit është magazinimi dhe tregtimi i karburanteve ne nje pike te furnizimit me pakice. Subjekti do te tregoje karburantet sipas kerkesave te klienteve konform ligjeve dhe regulloreve ne fuqi.

2.2. Vendndodhja e aktivitetit

Prona për të cilën po vlerësohet zhvillimi i këtij aktiviteti ndodhet në LEZHE Lagjja Beslidhja, Pike Karburanti, ngjitur me anen jugore te rruges "SHTRAUS", afro 150 m nga kryqezimi i lagjes GURRA te qytetit te Lezhes.

Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	Nr.	X	Y
	P.1.	4387909.9	4627670.1
	P.2.	4387911.23	4627663.64
	P.3.	4387917.33	4627658.39
	P.4.	4387918.65	4627646.08
	P.5.	4387952.27	4627646.81
	P.6.	4387949.47	4627670.93

§

Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ KRGJSH

Nr.	X	Y
P.1.	470922.28	4626716.91
P.2.	470923.68	4626710.47
P.3.	470929.84	4626705.29
P.4.	470931.31	4626693
P.5.	470964.91	4626694.12
P.6.	470961.83	4626718.2

Ky aktivitet zhvillohet ne nje zone urbane dhe eshte funksional prej shume vitesh. Pozicionimi përgjatë rruges kryesore dhe ne afersi te qytetit te Lezhes, si edhe krijimi i rrugëve hyrëse dhe dalëse mundëson zhvillimin e mire dhe krijon lehtësira në aksesimin ne aktivitet.

2.3 Lidhja e objektit me infrastrukturën inxhinierike

Objekti ku do zhvilohet aktiviteti në fjale ndodhet në brendësi të pronës dhe nuk cenon pronat e tjera përreth. Zona e vendndodhjes së objektit ka infrastrukturë ekzistuese rrugore, rrjetin elektrik dhe rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm.




Fig.. Ortofoto e vendndodhjes së veprimtarisë.
Burimi: google earth




Fig.. Paraqitja skematike e menyes se funksionimit te karburantit

2.4. Përshkrimi i proceseve teknologjike të aktivitetit

Kompania 'A.F.M.A' shpk merret kryesisht me ofrimin e shërbimit të tregtimit me pakice të karburanteve, sipas kontratës së licencës dhe dokumentave përkatëse për këtë aktivitet.

Shërbimet e këtij aktiviteti ofrohen sipas përcaktimeve ligjore dhe duke zbatuar kriteret përkatëse tekniko-ligjore.

Procesi i furnizimit me karbutant dhe gaz të lengshëm kryhet nga subjekti "A.F.M.A" sh.p.k. sipas përcaktimeve ligjore dhe sipas licencave dhe paisjeve përkatëse.

Subjekti A.F.M.A ka të depozituara sasitë e lendeve djegëse, përkatësisht sipas kategorive II/A Benzine, III/A Gazoil me kapacitet depozitues prej 60000 litra.

Karbutanti është i ndarë në 4 depozita, me kapacitet përkatësisht nga 15 mijë litra secila.

Sheshi ku ndodhet aktiviteti përbehet nga:

- Ambjente shërbimi
- Gropa e depozitave
- Mbulesa me lartësi 5m
- Platforma e pompave
- Sheshi i asfaltuar, parkim
- Gropa e dekantimit të grumbullimeve
- Vend shkarkimi i autoboteve

Sipas përcaktimeve edhe në projektin e mbrojtjes kundër zjarrit dhe shpëtimin, pika e karburantit nuk ka në afërsi, nën largësi limit të përcaktuara në noramë, ndërtesa të institucioneve shtetërore, shkollë, kopshte për fëmijë, depo dhe magazina me lende të ndezshme e plasese, stacione autobuzi, spitale etj.

Cdo depozitë ka bakaporta nëpërmjet kapakut të të cilës dalin linjat e tubacioneve për hyrje-dalje në karburant, për shkarkimin e avujve, për matjen e nivelit dhe për marrjen e kampionit.

Linja e ajrosjes së depozitave dalin tufë, në një zonë të lirë dhe larg nga objektet, sidomos nga zonat e rrezikshme për zjarr. Linjat janë të pajisura me flakepënguese. Të gjithë tubat e furnizimit janë xingato me diametër 1 ½".

Subjekti gjithashtu parashikon të shtojë në aktivitet një depozitë gazi me kapacitet 5000 litra. Ajo do të vendoset në bazamente betoni dhe do të jetë e pajisur me aksesoret e nevojshëm: valvulën e mbushjes, valvulën e shkarkimit, valvulën me dy veprime, valvulën e sigurisë, nivel matës dhe vëllimit të gazit të lëngzuar etj.

Pjesë e këtij aktiviteti janë dhe tenda e karburantit që zë një sipërfaqe prej 74 m²; pompat të cilat janë të pa lëvizshme dhe të montuara poshtë tendës, në bazamentin prej betoni. Ishulli i pompave është 4m i gjatë, 1 m i gjërë dhe 30 i lartë, me nga 4 pistoleta secila dhe me shërbim nga të dy anët për tregtimin e karburanteve.

3. INFORMACION PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS.

3.1. Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis.

Një nga objektivat e këtij raporti është identifikimi i ndikimeve të mundshme që mund të shkaktohen në mjedis nga ky aktivitet në terësi. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedisin e kësaj zone do të vlerësohen në një rën prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi aktiviteti është ekzistues dhe ndikimi në mjedis do të jetë vetëm gjatë ushtrimit të aktivitetit.

Shkarkime në ujë

Gjatë zhvillimit të aktivitetit nuk kemi ndotje të ujërave nëntokesorë apo sipërfaqësorë. Ujërat që dalin nga aktiviteti janë ujera të cilat lindin si rrjedhojë e aktivitetit të lagies së zonës së objektit, dhe ujërat e rreshjeve nga kushtet atmosferike. Në ujera mund të ketë si pasoje të difekteve të ndryshme gjatë procesit të punës ku mund të ndodhin rrjedhje të vajit apo karburanteve. Duke parë infrastrukturën e dedikuar të subjektit për grumbullimin e vajit të përdorur nuk parashikohet të ketë ndotje të ujërave nëntokësore ose sipërfaqësore.

Emetimet në ajër.

Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti, emetimet në ajër janë kryesisht: emetimet e gazeve që çlirohen nga lëvizja e automjeteve në perimetrin e servisit, shkarkimet gjatë provave të riparimit të automjeteve dhe pluhurat. Pra, mund të themi se niveli i shkarkimeve do të jetë normal për një zonë shërbimi dhe industriale, duke pasur parasysh mjetet rrugore që qarkullojnë të jenë konform normave të përcaktuara.

Ndikimet në tokë.

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë negativisht në tokë, kjo vjen si rezultat se nuk do të magazinohen lëndë të rrezikshme, Megjithatë mund të ketë ndotje në rast të pakujdesive apo aksidenteve në rrjedhjen e vajrave të automjeteve gjatë kohës që transportohen për në servis apo behen riparimet përkatëse.

Ndikimet në florë/ faunë.

Kjo zonë nuk bën pjesë në zonat e mbrojtura dhe aktiviteti nuk ndikon në florën dhe faunën e zonës në fjalë, pasi kjo zonë nuk ka bimësi për tu konsideruar, duke qenë se zona është plotësisht industriale dhe me aktivitete të ndryshme biznesi. Prona ku do të zhvillohet aktiviteti ka infrastrukture të ngritur. Në këtë prona është ndërtuar objekti me të gjitha instalimet e nevojshme për zhvillimin e këtij aktiviteti. Aktualisht zona është me karakter shumë ekonomik si edhe pozicionimi në zonë urbane jointensive kanë mbajtur larg faunën. Objekti ku kryhet aktiviteti ndodhet në një zonë ku janë ekzistues disa biznese industriale dhe përpunuese të kategorive të ndryshme.

Mbetjet e prodhuara.

Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti, mbetjet që do të prodhohen do të menaxhohen duke respektuar legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbetjeve. Grumbullimi i mbetjeve do të jetë i diferencuar që në vendburim për ato mbetje që është e mundur të kryhet ky proces. Në ndihmë do të vijnë edhe konteneret e Njesisë Administrative përkatëse.

Për një menaxhim të duhur të mbetjeve do të nënshkruhen kontrata përkatëse me subjektet e licensuara për trajtimin dhe menaxhimin e tyre. Nje prej tyre është dhe kontrata me subjektin e licencuar për marrjen dhe trajtimin e vajerave të përdorur.

Subjekti do të gjenerojë mbetje metalike dhe skrap nga shkatërimi i automjeteve si dhe nga procesi i zëvendësimit të pjeseve dhe riparimit të tyre.

Gjatë procesit mund të gjenerohen dhe mbetje nga boja si pasojë e ri-sprucimit të sipërfaqeve të automjeteve në këtë servis.

3.2. Masat e nevojshme për zbutjen e ndikimeve

Ndikimet negative në mjedis gjatë shfrytëzimit të objektit janë në nivele të ulta. Disa prej masave kryesore që do të ndërmerren janë përmendur në mënyrë të përmbledhur si më poshtë shënuar.

- Kontrollin dhe mbajtjen e ndikimeve brenda zonës së aktivitetit;
- Shmangien e efekteve negative në shëndet dhe mjedis;
- Kufizimi i veprimtarisë vetëm brenda objektit;
- Kontrolli i pluhurave nepërmjet lagies së zonës;
- Kontrolli i automjeteve për të parandaluar rrjedhjet e karburantit apo vajrave dhe çlirimet të normave të lejuara.
- Menaxhimi i pershtatshëm për grumbullimin e vajrave të përdorur dhe mbetjeve të tjera të gjeneruara.
- Vendosja e kontenerëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në venddepozitimin më të afërt të caktuar nga njësia administrative.
- Mirembajtja e sistemit të ndarjes së ujërave të kanaleve të grumbulluara nga kanalet sipërfaqësore të objektit dhe vajrat e grumbulluar.
- Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujërave teknologjike të largës dhe të shiut.
- Mbjellja e pemëve dekorative përreth objektit për të krijuar një ambient të pastër dhe rekreativ.

Do të respektohen të gjitha kushtet dhe masat në Lejen e Mjedisit që do të vendosen nga AKM-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

4.PROGRAMI I MONITORIMIT

4.1 Qëllimet e monitorimit mjedisor

Qëllimi i monitorimit mjedisor është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

4.2 Objektivat e Monitorimit:

- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve. Për të siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të tyre.
 - Për të evidentuar cilësinë e mjedisve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor, me synim për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre.
 - Për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore.
 - Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në zonë, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
 - Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
 - Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

5. PËRPARËSITE E PROJEKTIT/PËRFUNDIME

- Pozicionimi përgjatë rruges kryesore si edhe krijimi i rrugëve hyrëse dhe dalëse mundëson zhvillimin e këtij aktiviteti dhe krijon lehtësira në aksesimin e tij nga qytetaret.
- Gjatë funksionimit të tij nuk do të shkaktohet ndotje të medha të tokës, ajrit, ujit.
- Me vendosjen e kontejnereve të veçantë për grumbullimin e mbeturinave që do të gjenerohen nga zhvillimi i aktivitetit, dhe nënshkrimi i kontratave me subjektet e licencuara për trajtimin e tyre, do të zgjidhet problemi i trajtimit të tyre dhe në të njëjtën kohë do të parandalohet ndotjen e mjedisit.


ANEKSI 1

Pamje nga aktiviteti.



ANEKSI 2

Dokumentat e pronës ku është vendosur aktiviteti:


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Zyra e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme

ÇERTIFIKATË 1178910
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit: Z.V.R.P.P. LEZHË Zona Katshtetale Nr 8632
Numri i Pasurisë: 5/131 Vëllimi 30 Faqe 220
Adresa e Pasurisë: LEZHË
Lloji i Pasurisë: TRUALL
Sipërfaqja Totale: 845.00 m²
Nga kjo : Sa Tërës: 845.00 Nga kjo : Sa Ndërtesa: 228.50
Nga parat : Kosta e përcaktimit: %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zot (Zotëritë)				
Emri	Adresa	Mbiemri	Pjesa	Adresa LEZHË
* AFMA	SH. P. K		1 / 1	

- është pronar i pasurisë me numër 5/131
- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kultimet e pasurisë janë : V _____ L _____ J _____ P _____

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga (të) interesuari (t) më datë 12/11/2015 Nr. 26375

Lëshuesi i certifikatës
REGJISTRUESI
ARDIAN SIMONI

Data e lëshimit të certifikatës
15/1/2016

HARTA E DOKUMENTIT TREGUESOR

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE
PALUANTSHME

LEZHE

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

NUMERI I PAFILIT 8632 NO. I TAPIT 5/131 NO. I KATIT 30 220
NO. I DOKUMENTIT LE-7-5 SHALLI 1:500
LLOJI I PASURISE LEZHE / LEZHE / RESOLICION

B. KUFIZI I JET

C. PRONARI

5/3

5/130

"AFMA" SH.R.K.

5/13

5/98


04.12.2015

10⁴⁵

Ing. F. ZILFI



5
9



5
13



Certifikatat e prones dhe hartat treguese